

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
REKTORATI

Pranuar me dt. 13.3.2020			
Nj. org.	Nr. titull.	Nr. ekzempl.	Vlera
05	929		



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”

PLANI STRATEGJIK
2020-2022

PRISHTINË, MARS 2020



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	2
FJALA E REKTORIT	4
PROCESI I HARTIMIT TË PSUP-së 2020-2022	5
VIZIONI	7
HYRJE	9
PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE DHE INICIATIVAVE STRATEGJIKE	15
Fushat strategjike, objektivat e iniciativave strategjike	16
(1) Mësimdhënia dhe mesimnxënia	16
(2) Puna kërkimore shkencore/artistike	17
(3) Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi	17
(4) Niveli i studimeve dhe programet e kërkuara nga tregu	17
(5) Zhvillimi i burimeve njerëzore	18
(6) Zhvillimi i sistemit të IT-së	18
(7) Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave	18
(8) Zhvillimi i infrastrukturës	18
(9) Globalizimi/ndërkombëtarizimi	18
MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI	19
PLANI I VEPRIMIT 2020-2022	21



SHKURTESAT

BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
GTZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
KQSC	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJA	Njësitë Akademike
PA	Parlamenti Studentor
QPM	Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
QUGJ	Qendra Universitare për Gjuhë
QZHK	Qendra për Zhvillimin e Karrierës
SHU	Shoqatat e Universitetit
TI	Teknologjia e Informacionit
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Ndihma e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
ZBN	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar ZIK – Zyra për Integrim dhe Koordinim
ZZHC	Zyra për Zhvillim të Cilësisë



DOKUMENTET E KONSULTUARA

- Plani Strategjik i UP-së 2017-2019;
- Strategjia për Cilësi e Universitetit të Prishtinës 2012 – 2017;
- Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;
- Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2013-2015;
- Statuti i Universitetit të Prishtinës;
- Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016;
- Universiteti i Prishtinës - Asistencë Teknike për Zyrën e Rektorit, raporti i USAID 2013.
- Dokumente strategjike të disa prej universiteteve të vendeve evropiane.

FJALA E REKTORIT



Kam kënaqësinë e veçantë që në emër të menaxhmentit të UP-së, stafit akademik dhe studentëve, ta përgëzoj këshillin drejtues dhe grupin punues për hartimin e “Strategjisë Zhvillimore 2020-2022”.

Universiteti i Prishtinës vazhdon të bartë mbi vete barrën kryesore të edukimit dhe zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi në Kosovë. Kjo strategji, e cila është reflektim dhe vazhdimësi e punës së realizuar të Planit Strategjik të Universitetit të Prishtinës 2017-2019, e cila është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve nga fusha të ndryshme akademike dhe partnerëve, do të jetë dokument në të cilin mbështetet Universiteti i Prishtinës për të zhvilluar, konsoliduar dhe ndërtuar struktura dhe mekanizma që promovojnë zhvillimin e këtij institucioni në një nivel të krahasueshëm me universitetet prestigjioze nga vendet më të zhvilluara.

Tutje, kjo strategji adreson nevojën që të precizohen masat dhe instrumentet që UP-ja, si institucion i arsimit të lartë, duhet të ndërmarrë që zhvillimi akademik të jetë i lidhur më ngushtë me arsimin e lartë, tregun e punës, ndërkombëtarizimin dhe nevojat e shoqërisë në tërësi. Ndikimi i kësaj mund të shihet në programet e reja të zhvilluara dhe freskimi i atyre ekzistuese për profilet përkatëse të bazuara në përvojën ndërkombëtare, organizimin e trajnimeve për personelin, rritjen graduale të mobilitetit të studentëve, rritjen në vazhdimësi të hulumtuesve shkencorë të rinj, të angazhuar në punë kërkimore, shkencore dhe artistike, publikimet ndërkombëtare, zhvillimin e projekteve bashkëpunuese të Universitetit të Prishtinës si dhe kontributin e përgjithshëm në nivel vendi.

Strategjia avancon disa hapa më tutje edhe marrëdhëniet e Universitetit të Prishtinës me agjencitë qeveritare, me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, me institucionet tjera kërkimore-shkencore dhe fondacione të tjera.

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës mbetet i përkushtuar të analizojë, detajojë dhe zbatojë këtë strategji, për të arritur rezultate të krahasueshme në nivel ndërkombëtar si dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Prof. dr. Marjan DEMA, Rector



PROCESI I HARTIMIT TË PSUP-së 2020-2022

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues (KD) të UP-së të datës 14.11. 2019 është formuar komisioni për hartimin e Strategjisë së UP-së bazuar në vendimin nr: 4/28 të dates 21.11.2019, bazuar në nenin 22 të Statutit të UP-së, për periudhën trevjeçare. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të UP-së do të udhëhiqen nga ky dokument, i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturave menaxhuese të UP-së mbi bazën e monitorimit dhe rivlerësimit vjetor të tij.

KD-ja ka emëruar grupin punues të ngushtë, të përbërë prej 7 anëtarësh: Prof. dr. Hysen Bytyçi, prof. mr. sc. Drita Shoshi-Begolli, prof. dr. Naser Kabashi, dr.sc. Ujkan Bajra, prof. asoc. dr. Zeqir Veselaj, prof. asoc. dr. Kreshnik Hoti dhe msc. Esat Kelmendi.

Grupi punues fillimisht ka kompletuar portfolion e gjithë dokumentacionit relevant për hartimin e dokumentit të Planit Strategjik të Universitetit të Prishtinës (PSUP) me fokus në dokumentet strategjike për arsimin e lartë të MASHT-it (PSAK 2017-2020), dokumentet sektoriale strategjike të UP-së (për kërkime-hulumtime, për sigurimin e cilësisë, Plani Strategjik i UP-së 2017-2019), dokumentet ndërkombëtare të arsimit të lartë, etj.

Përgatitja e dokumentit ka ndjekur dinamikën e aprovuar nga KD-ja, që ka përfshirë fazat: draftimin e dokumentit nga Komisioni i KD-së, finalizimin e dokumentit për diskutim, diskutimin publik me zyrat menaxheriale dhe njësitë akademike, studentët, donatorët dhe partnerët, para se të aprovohet nga KD-ja.

Grupi punues ka mbajtur shtatë takime pune dhe konsultative, në të cilat ka përcaktuar prioritetet dhe ka punuar një draft fillestar, i cili u është dërguar për kontribute shtesë të gjitha njësive akademike dhe zyrave relevante të UP-së.

Pas kësaj, draft-dokumenti, përmes dekanëve, i është dërguar për diskutim publik personelit të njësive akademike brenda datave 26.02 - 04.03.2020. Këshilli drejtues falënderon të gjithë ata që kontribuan në çfarëdo mënyre në hartimin e PSUP-së 2020-2022.



GRUPI PUNUES

Në hartimin e këtij dokumenti ka qenë përgjegjës grupi punues i përberë prej:

1. Prof. dr. Hysen Bytyçi (kryesues),
2. Prof. mr. sc. Drita Shoshi-Begolli (anëtare),
3. Prof. dr. Naser Kabashi (anëtar),
4. Dr.sc. Ujkan Bajra (anëtar),
5. Prof. asoc. dr. Zeqir Veselaj (anëtar),
6. Prof. asoc. dr. Kreshnik Hoti (anëtar),
7. Msc. Esat Kelmendi (anëtar).



VIZIONI

Universiteti i Prishtinës është një institucion i arsimit të lartë, i njohur globalisht për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtim. Në harmonizim me nevojat e ekonomisë dhe të tregut, do të vendosë dhe mirëmbajë standarde të cilësisë, duke përkrahur mobilitetin dhe zhvillimin e karrierave akademike për personelin dhe studentët, duke e rritur numrin e partnerëve dhe duke iu bashkuar rrjetit të edukimit të lartë evropian.

MISIONI

Misioni i UP-së bazohet në zhvillimin akademik, hulumtimet shkencore, artistike dhe sigurimin e arsimit të lartë përmes programeve me interes strategjik dhe zhvillimor të Republikës së Kosovës. Universiteti mundëson mobilitetin e programeve, studentëve dhe stafit akademik në vazhdimësi, me qëllim të arritjes së nivelit ndërkombëtar dhe konkurrencës në treg.


Misioni i universitetit bazohet në aspiratat e qytetarëve të vendit përmes sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, zhvillimin akademik, shkencor, artistik apo edhe disiplinave me interes kombëtar për Republikën e Kosovës.

Universiteti është institucion publik autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. Universiteti ka këto qëllime:

- Të veprojë si qendër institucionale dhe udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
- Të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
- Të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
- Të synojë të krijojë dhe të mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
- T'i shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase;
- Të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;



- Te promovojë dhe të zbatojë standardet evropiane për zhvillim të qëndrueshëm;
- Të integrohet plotësisht në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore si dhe të ndër marrë hapa adekuatë reformues të nevojshëm për arritjen e këtij misioni;
- Të orientohet drejt inovacionit dhe ekselencës në kërkimin shkencor.





HYRJJE

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është institucion publik, më i madhi në vend në ofrimin e arsimit të lartë. Nën ombrellën e vet, UP-ja numëron gjithsej 14 njësi akademike dhe mban përgjegjësinë shtetërore dhe qytetare në edukimin e mirëfilltë të të rinjve të Republikës së Kosovës, për t’i përgatitur si qytetarë të denjë dhe të dobishëm për nevojat e Kosovës.

1. Fakulteti Filozofik;
2. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore;
3. Fakulteti i Filologjisë;
4. Fakulteti Juridik;
5. Fakulteti Ekonomik;
6. Fakulteti i Ndërtimtarisë;
7. Fakulteti i Arkitekturës;
8. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
9. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
10. Fakulteti i Mjekësisë;
11. Fakulteti i Arteve;
12. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
13. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit;
14. Fakulteti i Edukimit.

Qëllimi i UP-së, qysh prej themelimit e deri në ditët e sotme, ka qenë promovimi i jetës akademike e intelektuale dhe i ndryshimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në përparim të vendit dhe shoqërisë kosovare. Ai ka qenë prijës i proceseve me rëndësi jetike për shtetin e Kosovës dhe, përkundër sfidave e vështirësive, UP-ja i ka mbijetuar kohës, duke u përkushtuar me të gjitha forcat për edukimin e brezave për një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Për më tepër, UP-ja mbetet institucioni lider dhe më i besueshëm në Kosovë e më gjerë për nxënie të dijes dhe zhvillim të kadrove të reja. Megjithatë, krahas përparësisë që ofron për të rinjtë kosovarë, rankimi aktual i shton përgjegjësitë dhe obligimet shtesë për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në përmbushje të kërkesave të studentëve dhe shoqërisë në përgjithësi.



Diversiteti, numri i madh i studentëve, numri i programeve dhe nevojat e tregut për njerëz të kualifikuar shtojnë sfidat për zhvillim të vazhdueshëm për të mbajtur hapin dhe plotësuar nevojat e ekonomisë kosovare.

UP-ja, gjatë viteve të fundit, ka punuar pa reshtur në forcimin dhe zgjerimin e institucionit, duke ndjekur trendet e zhvillimit të arsimit të lartë në Evropë dhe SHBA. UP-ja veçohet si institucion i parë në rajon në përshtatjen e programeve të studimeve sipas Sistemit të Bolonjës si dhe të aplikimit të ECTS-ve në të gjitha programet.*

Përkundër proceseve politike dhe ekonomike, nëpër të cilat ka kaluar vendi, gatishmëria dhe përkushtimi i UP-së për të ofruar shërbime dhe arsim cilësor nuk ka munguar në asnjë kohë. Megjithatë, ndryshimet që teknologjia dhe zhvillimet e shpejta të saj i kanë sjellë tregut vendor dhe global përbëjnë një sfidë për UP-në, e cila përgatit numrin më të madh të të punësuarve aktualë dhe të ardhshëm në vend. Kjo është një sfidë dhe barrë e madhe për UP-në dhe kërkon mobilizim dhe organizim të shpejtë në adresim të kësaj sfide në mënyrën më të mirë të mundshme.


Zhvillimet e viteve të fundit në strukturat më të larta të menaxhmentit brenda UP-së tregojnë qartazi se përkundër vështirësive që mund të hasen në proces, UP-ja ka marrë shumë seriozisht nevojën për ndryshime, kështu që arsyeja dhe vullneti i përgjithshëm për këtë ndryshim ekziston.

Si rrjedhojë e gjendjes aktuale në UP dhe kërkesave të tregut kosovar të punës, UP-ja, me përkrahje të MASHT-it, USAID-it, Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), Komisionit Evropian (KE) dhe organizatave të tjera vendore dhe ndërkombëtare, të cilat me vite ndihmojnë zhvillimet në UP, me iniciativë të Këshillit Drejtues (KD) dhe rektorit, ka punuar në Planin Strategjik në adresimin e sfidave dhe nevojave me të cilat përballet sot UP-ja.

Pas analizave dhe nevojave të bëra vite më parë, të përkrahura nga organizatat e përmendura më lart, dhe analizave të fundit brenda UP-së, është realizuar dokumenti “Plani Strategjik i UP-së 2020-2022”, i cili do të adresojë çështjet që lidhen me ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet e UP-së. Për organizim dhe implementim sa më të mirë të aktiviteteve të planifikuara, grupi punues ka organizuar, sipas fushës, këto aktivitete dhe nevoja në nënte (9) shtylla kryesore, të cilat janë të paraqitura në vijim në dokument.



Me adresimin e kësaj strategjie, e cila ngërthen në vete një numër të iniciativave strategjike, periudhën kohore, akterët përgjegjës dhe koston që secila prej tyre kërkon për implementim, UP-ja synon të arrijë të përmbushë misionin e saj si institucioni më i madh në vend në ofrimin e arsimit të lartë.





PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Përmes kësaj strategjie, UP-ja vendos objektiva strategjike, të cilët kanë për qëllim final ofrimin e një ambienti të mirëfilltë edukativ e shkencor, ku rritja e cilësisë së shërbimeve të mësimdhënies dhe komponentes shkencore është thelbi i saj. Andaj, me implementimin e këtij dokumenti, UP-ja ka për synim që të përmbushë qëllimin e vet duke:

- Aplikuar standardet, rregulloret dhe transparencën në përzgjedhjen e stafit akademik;
- Ofruar zhvillim profesional të stafit akademik në metodat e mësimdhënies në dobi të studentëve;
- Siguruar komunikimin e vazhdueshëm student-mësimdhënës për arritjen e rezultateve më të mira të mësimnxënies;
- Nxitur kërkimin shkencor të mësimdhënësit dhe studentët;
- Orientuar studentët që të jenë pjesë e forumeve ndërkombëtare në rritjen e kapaciteteve, për ndryshimet apo përmirësimet konform kërkesave të kohës.

Shërbimet e informacionit dhe ato administrative janë të domosdoshme që të garantojnë mbarëvajtje të punëve dhe proceseve brenda UP-së. Digjitalizimi dhe ofrimi i informacionit në kohë, lehtëson arritjen e objektivave strategjike dhe përmbushjen e misionit të universitetit, andaj synimet e përgjithshme të strategjisë po ashtu kanë qëllim të:

- Avancojnë cilësinë e shërbimeve administrative në UP, sipas nevojës për shërbime digjitale;
- Përhapin informacionin për të gjitha aktivitetet e rëndësishme në UP dhe organizimet nga forumet ndërkombëtare;
- Ofrojnë qasje në platformat elektronike gjatë gjithë kohës;

Infrastruktura dhe mjetet e punës në UP janë domethënëse, për të arritur një performancë sa më të lartë. Kushtet e punës dhe ndërtimi i hapësirave të reja në dobi të punës mësimore dhe hulumtuese janë bazë e rëndësishme dhe kërkojnë vëmendjen e akterëve brenda UP-së. Përmes strategjisë synohet të identifikohen dhe vendosen objektiva të arritshme, që si synim përfundimtar kanë rritjen e cilësisë së jetës dhe shërbimeve në kampus dhe hapësirat e universitetit në përgjithësi. Andaj, përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja, të cilat adresohen në këtë dokument, kanë për qëllim:



- Rritjen e numrit dhe sipërfaqen e objekteve mësimore në përputhje me numrin e studentëve;
- Ofrimin e sallave mësimore dhe laboratorë të pajisur me mjetet e punës dhe teknologji, varësisht prej nevojave të programit;
- Ofrimin e ambienteve komode/ambiente për lexim, duke pajisur bibliotekat me kompjuterë për qasje në e-bibliotekat dhe pajisje të nevojshme në lehtësim të procesit të mësuarit;
- Sigurimin e kushteve infrastrukturore për qasjen e lehtë të personave me aftësi të kufizuara në kampusin e UP-së dhe në marrjen e shërbimeve nga UP-ja.

Optimizimi i resurseve, infrastrukturës dhe kapitalit human pritet të prodhojë performancë të pranueshme edhe ndërkombëtarisht, që në fakt edhe përkon me vizonin dhe misionin e UP-së. Komponent kryesor që e bën të besueshme se shfrytëzimi i resurseve të universitetit po bëhet në një ambient të mbuluar me kontrole adekuate që minimizojnë rrezikun operacional e më gjerë dhe rrisin përfomancën. Kompetenca profesionale dhe adaptimi i politikave të mirëfillta qeverisëse po ashtu janë faktorë që sigurojnë arritjen e qëllimeve strategjike. Emëruesi i përbashkët i tërë këtij mozaiku është cilësia e programeve për sigurim të akreditimit të vazhdueshëm me synimin për të:

- Fuqizuar një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë;
- Analizuar dhe mbikëqyrur vazhdimisht mbarëvajtjen e programeve;
- Ofruar programe të reja apo rishikimin e programeve aktuale, varësisht prej nevojave të tregut të punës;
- Mbikëqyrur dhe vlerësuar angazhimin e stafit akademik;
- Përshtatur numrin e stafit akademik me numrin e studentëve për një mësimnxënie efektive;
- Aplikuar te nxënit aktiv me qëllim të zhvillimit të mendimit kritik të studentëve dhe shprehjes së lirë;
- Marrë parasysh informatat kthyesë nga bordet këshillëdhënëse, që orientojnë në plotësimin apo përmirësimin e programeve studimore në njësitë akademike.



Një mangësi, me të cilën është ballafaquar deri tani UP-ja, është sigurimi dhe përdorimi efikas i buxhetit në realizimin e prioriteteve të UP-së. Në këtë dokument, synohet organizimi/planifikimi i mirëfilltë i buxhetit apo parasë publike dedikuar UP-së, si dhe donacioneve nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, duke ndërtuar një regjistër dhe ruajtje të të dhënave të këtyre të hyrave me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë dhe transparent. Gjithashtu, do të nxitet puna me ekonomi dhe ofrimin e shërbimeve, për të rritur të hyrat në UP, në mënyrë që të rriten shërbimet për studentët në mbështetje të aktiviteteve kurrikulare, por edhe jokurrikulare, si dhe në ndërtimin e një lidhjeje më të fortë dhe të qëndrueshme mes komunitetit dhe UP-së.

Të gjitha këto ndryshime në përmirësim të shërbimeve në UP dhe në ngritje të cilësisë së arsimit do të mundësojnë forcimin si dhe rritjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare, të cilat jo se i kanë munguar UP-së në të kaluarën, por nevojat dhe kërkesat sot janë shumë më të mëdha. UP-ja ka një përvojë të suksesshme në bashkëpunim ndërkombëtar. Universiteti Veror çdo vit pret studentë ndërkombëtarë dhe staf akademik nga vende të ndryshme të Evropës dhe botës. Për më tepër, UP-ja ka nevojë për rritje të mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve me institucione të ndryshme të arsimit të lartë jashtë Kosovës në funksion të shkëmbimit të përvojave akademike, ofrimit të shërbimeve në hap me kohën. Kjo është e mundur përmes programeve që ofrohen: (Horizon 2020, Erasmus +, CEPUS, etj.). Në kuadër të ndërkombëtarizimit/globalizimit të UP-së, synohet ofrimi i programeve në gjuhën angleze, në programet që janë atraktive për tregun dhe që studentëve me një diplomë të tillë do t'u hapte edhe më tutje rrugët në karrierë, duke krijuar mundësi për diploma të përbashkëta me universitete partnere: (Joint Degree Diploma apo edhe Double Degree Diploma).

Sigurisht që realizimi i këtij plani strategjik dhe planit të veprimit ka implikimet financiare dhe sfidat e veta, varësisht prej fushës që ato mbulojnë. Është e rëndësishme të theksohet se shumica e këtyre iniciativave nuk kërkojnë implikime të mëdha buxhetore dhe janë të përballueshme nga buxheti ekzistues apo i paraparë i UP-së.

Megjithatë, disa aktivitete kërkojnë përkrahje financiare nga komuniteti i donatorëve, të cilët besojmë se do ta përkrahin edhe në këtë proces, ashtu siç kanë përkrahur deri më tani në projekte të ndryshme.



UP-ja është bindur që me implementimin e këtyre iniciativave në strukturat organizative përkatëse të UP-së do të ndryshojnë pozitivisht zhvillimet në UP në arritjen e qëllimeve të përbashkëta për një arsim sa më cilësor dhe për një punësim sa më të madh të të diplomuarve në UP, të cilëve nuk do t'u mungojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat që sot i kërkon tregu i punës. Prandaj, implementimi i këtij plani strategjik shtrohet si një obligim për të gjithë akterët e UP-së, për të punuar në përmbushjen dhe avancimin e misionit të UP-së si dhe obligimeve që UP-ja ka ndaj studentëve dhe qytetarëve të Kosovës për një arsim cilësor dhe me vlera.

PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE DHE INICIATIVAVE STRATEGJIKE

Në përputhje me vizionin dhe mision e vet, Universiteti i Prishtinës ka identifikuar një numër të objektivave strategjikë, me synimin përfundimtar që të avancojë pozitën konkurruese përmes ofrimit të shërbimeve cilësore, pa dallim, për nevojat e popullsisë së Kosovës dhe më gjerë. Për këtë qëllim, ne kemi identifikuar prioritetet në përputhje me kapacitetet dhe resurset njerëzore/humane, financiare e logjistike, ashtu që universiteti të zhvillohet dhe udhëhiqet drejt përmbushjes së objektivave strategjikë. Prioritetet janë si në vijim:

Rritja e cilësisë në arsim dhe kërkim shkencor/artistik – Krijimi i një modeli të ri për arsimin parauniversitar për të përgatitur më mirë studentët e UP-së për një botë në ndryshim. Zhvillimi dhe zbatimi i një modeli të ri konkurrues në mësimdhënie, hulumtim dhe të shërbimeve në UP për të arritur qëllimin e renditjes në mesin e 1000 institucioneve më të mira në botë në rangimin botëror deri në 2027.

Nxitja e hulumtimeve kërkimore shkencore/artistike – Të mbështesim misionin tonë kërkimor duke rritur financimin institucional dhe shpenzimet kërkimore me 1 % të buxhetit të UP-së; të ofrojë investime me shënjestër kërkimin më të avancuar dhe punën krijuese.

Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e programeve – Duke u bazuar në kërkesat e tregut dhe konkurrencës globale, kjo do të kërkojë ndjekjen e trendeve në zhvillimin e vendeve të punës dhe nevojave si dhe të një procesi për të matur qëndrueshmërinë e programeve aktuale dhe programet e ardhshme në universitet.

Mbështetja e zhvillimit të UP-së – Rritja e resurseve që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të universitetit. Investimi në mjete për sukses. Rritja e investimeve



në teknologji të reja, objekte të reja dhe ekzistuese në kampus, si dhe shfrytëzimi i bibliotekës, koleksioneve dhe qasja në to.

Diversiteti si proces – Zbatimi i strategjive të reja për rritjen dhe përmirësimin e diversitetit; të nxisë një klimë mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.

T'i shërbejmë Kosovës, komunitetit dhe të diplomuarve tanë – Zgjerimi i programit në terren për komunitetet në Kosovë; rritja e mundësive për mësim tërëjetësor, mësim gjatë gjithë jetës dhe mësim në distancë.

Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike dhe shërbimeve studentore të fakulteteve të UP-së për të nxitur shkëmbimin maksimal dhe lejimin e kompetencave përtej kufijve.

Këto janë nëntë fusha strategjike të identifikuara në planin e parashtruar në këtë strategji. Çdo fushë strategjike është ndarë në objektiva me iniciativa strategjike të implementimit, masat, afatet kohore, stafin përgjegjës dhe burimet e nevojshme për të realizuar objektivin. Renditja e iniciativave strategjike i ofron UP-së fusha me fokus për tre vjetët e ardhshëm. Lista është një përmbledhje e prioriteteve që duhet të konsiderohen si fusha me fokus institucional, por progresi dhe fokusi duhet të rishikohen duke u bazuar në indikatorë dhe në një proces periodik formal të rishikimit dhe rivlerësimit të planit, së paku një herë në vit. Iniciativat strategjike të renditura janë hartuar me qëllim që secila të jetë e veçantë (të mos përsëriten), por në një plan organizativ kompleks disa nga iniciativat mund edhe të duken si të përsëritura apo të ngjashme.

Fushat strategjike, objektivat e iniciativave strategjike

(1) Mësimdhënia dhe mesimnxënia

- (a) Përmirësimi i mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja;
- (b) Sigurimi i zhvillimit të stafit akademik me qasje pedagogjike;
- (c) Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes në metodologjinë e hulumtimit, analiza statistikore, shkrimit për revista, ditarë dhe koston e publikimit sipas nevojës;
- (d) Rritja e mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve, që janë burim i të hyrave të universitetit;

- (e) Krijimi i praktikës për shërbim të komunitetit nga stafi akademik;
- (f) Ngritje e performancës akademike.

(2) Puna kërkimore shkencore/artistike

- (a) Rritja e rezultateve kërkimore –shkencore/artistike të stafit akademik në revista konkurruese të pranura ndërkombëtarisht në fushën e tyre;
- (b) Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes në metodologjinë e hulumtimit, analiza statistikore, shkrimit për revista, ditarë dhe koston e publikimit sipas nevojës;
- (c) Rritja e mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve, që janë burim i të hyrave të universitetit;
- (d) Krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare.

(3) Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi

- (a) Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies për të arritur rezultate më të mira të mësimit dhe rritjes së interesimit për njohuri të ofruara;
- (b) Rritja e cilësisë së stafit akademik, progresit të studentëve, vlerësimi i lëndës dhe rezultatet e përgjithshme;
- (c) Krijimi i një fondi të bursave për vizita kërkimore afatshkurta jashtë vendit;
- (d) Zhvillimi i programeve të doktoratës në synim në gjuhën angleze dhe në përputhje me sistemin e Bolonjës;
- (e) Rritja dhe përmirësimi i rezultateve shkencore dhe kërkimore në UP;
- (f) Përforsimi i marrëdhënieve të universitetit me tregun e punës dhe komunitetin;
- (g) Institucionalizimi i përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë;
- (h) Dizajnimi dhe implementimi i indikatorëve kyç çelës të performancës akademike (KPI-A).

(4) Niveli i studimeve dhe programet e kërkuara nga tregu

- (a) Zbatimi i programeve në pajtim me nevojat e tregut;
- (b) Zhvillimi i rezultateve të matshme të programit;



- (c) Rritja e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat për t'i lidhur programet me kërkesën, aftësitë aktuale dhe kërkesat e njohurive dhe nevojat e ardhshme;

(5) Zhvillimi i burimeve njerëzore

- (a) Zhvillimi i organogramit të personelit dhe strukturave të ardhshme të stafit;
(b) Rritja e trajnimit të stafit administrativ;
(c) Përmirësimi i rekrutimit dhe praktikave të punësimit;
(d) Qartësimi i detyrave të punës dhe përgjegjësi për stafin administrativ.

(6) Zhvillimi i sistemit të IT-së

- (a) Implementimi i sistemit informativ globalisht konkurrues;
(b) Zhvillimi i shërbimeve studentore me standardet e BE-së/SHBA-së;
(c) Inicimi i sistemit të zhvillimit të studentëve për të mësuarit në tërësi;
(d) Fuqizimi i rrjetit alumni;

(7) Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave

- (a) Hartimi dhe zbatimi i financave dhe sistemeve buxhetore (politikat, softuerë, proceset, trajnimi dhe shfrytëzimi) për përmirësimin e menaxhimit të universitetit dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies.
(b) Raportimet e ndërsjella për realizimin e objektivave dhe iniciativave strategjike.

(8) Zhvillimi i infrastrukturës

- (a) Zhvillimi i mëtejshëm i bazës së të dhënave dhe inventarit të infrastrukturës së UP-së për të gjitha NjA-të;
(b) Implementimi i master planit të sistemeve fizike dhe infrastrukturës;
(c) Zhvillimi i strategjisë për menaxhimin e burimeve të kampusit;
(d) Mundësia e zhvillimit të infrastrukturës për aktivitete në kampus;
(e) Përmirësimi i infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara në ndërtesat e UP-së.

(9) Globalizimi/ndërkombëtarizimi

- (a) Zbatimi i programeve/niveleve studimore në gjuhën angleze me partnerët ndërkombëtarë;

- (b) Rritja dhe funksionalizimi e partneriteteve globale;
- (c) Rritja e numrit të aplikimeve për mobilitet dhe bursa (Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar);
- (d) Përkrahja e stafit për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare;
- (e) Rritja e efikasitetit të verifikimit të transkripteve dhe dokumenteve (sipas kërkesës se partnerëve ndërkombëtarë);
- (f) Baza e të dhënave elektronike për menaxhimin e donacioneve dhe projekteve ndërkombëtare;
- (g) Rritja e bashkëpunimit me publikun ndërkombëtar jouniversitar apo korporatat private.

Iniciativat strategjike janë prezantuar më poshtë në formë tabelare për t'u lexuar dhe ekzekutuar më lehtë. Njësitë administrative dhe akademike të Universitetit të Prishtinës pritet që të zhvillojnë plane për zbatimin e iniciativave, objektivave dhe detyrave/aktiviteteve brenda njësisë të tyre. Plani do të vazhdojë të zhvillohet me të dhëna/inpute nga palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme, në mënyrë që të mbetet një dokument.

MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie dhe synojnë matjen e progresit të arritur. Këshilli Drejtues i UP-së emëron një komision për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie, sipas dinamikës së paraparë për Planin e Veprimit. Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat relevante të UP-së, do të monitorojë rregullisht zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie dhe në etapa të caktuara të raportojë. Këshilli Drejtues i UP-së do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie.


Të dhënat që njësitë akademike dhe zyrat përkatëse do të dorëzojnë në komision për monitorim dhe vlerësim duhet të përfshijnë: aktivitetet e realizuara dhe progresin, efektet, ndikimet, vështirësitë, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet.



Zyrtarët përgjegjës do të marrin të dhëna edhe nga donatorët. Për të siguruar monitorimin e duhur të Planit të Veprimit janë përcaktuar treguesit për monitorimin e zbatimit të strategjisë. Këta tregues do të mundësojnë monitorimin e progresit, duke vënë në dukje nivelin e arritjes së objektivave dhe realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie. Kjo strategji është një dokument aktiv dhe do të rishikohet e do të plotësohet në baza vjetore.

Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie përmes Planit të Veprimit iu siguron zbatuesve të saj një pasqyrë, e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat, me të cilat përballet aktualisht sektori i arsimit të lartë, por edhe në të ardhmen. Plani i Veprimit i kësaj strategjie është ndërtuar në një strukturë tabelare, progresi i të cilit do të monitorohet rregullisht në takimet e rregullta të udhëhequra nga Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim.

Në fund të zbatimit të strategjisë do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të kontrolluar deri në çfarë mase kjo strategji ka ndikuar në fuqizimin e universitetit, duke i konsideruar si bazë dokumentet relevante nga MASHTI.



**PLANI I VEPRIMIT 2020-2022**

Fushat strategjike

1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – aktivitetet	Indikatorët	Afatet kohore	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/kosto në euro
Përmirësimi i udhëzimeve bazuar në metodologjitë dhe kërkesat e kohës	Ofrimi i mundësive për lehtësi të nxënies së njohurive nga studentët dhe krahasueshmëria me rezultatet e arritura.	-Avancimi dhe qasja elektronike në SEMS për studentët, përfshirë të gjitha informatat e nevojshme për lëndët, notat, aktivitetet dhe të dhënat e studentëve (kursët). (Migrimi i të dhënave/platformave shtesë).	-Të gjithë studentët të pajisen me e-mail dhe kartelë zyrtare të studentit. -Të vendoset i gjithë materiali mësimor në SEMS dhe platformat tjera të specializuara për mësimdhënie interaktive. - Avancim i e-student në platformën SEMS. - Avancim i e-stafi akademik në platformën SEMS. - Avancim i e-stafi administrativ në platformën SEMS. - Vendosja e platformave shkencore dhe shërbimeve tjera për studentë dhe stafin (p.sh. sciensedirect, ëeb of science, Moodle, Turnitin, etj.).	Prill, 2020- vazhdon	Menaxhmenti i UP-së ZTI/ ZZHA/ / NJA	70.000
		-Evidentimi i ngecjeve dhe trajnimet e rregullta apo edhe ad hoc për mësimdhënësit. Përbushja e kushteve dhe standardeve të detajuara.			ZPM/IHZHA / ZZHA/KC/Nj A	10.000 10.000



PLANI STRATEGJIK I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS 2020-2022

		Përmirësimi apo përsosmëria e programeve të studimeve konform kërkesave të parashtruara nga informatat kthjese nga nevojat e tregut.	<ul style="list-style-type: none">- Numri i stafit të trajnuar- Niveli i trajnimit- Konsultimi me trupat këshillëdhënëse;- Rishikimi i syllabuseve dhe adaptimi i programeve studimore;- Programi i akredituar			
--	--	--	--	--	--	--



1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – aktivitetet	Indikatorët	Afatet kohore	Stafi / përgjegjësitetë	Burimet/ kosto në euro
Shërbime për komunitetin	Gatishmëria dhe përvoja e UP-së për të ofruar dije dhe shërbime sipas kërkesave të komunitetit	-Të zhvillohet një sistem i politikave për shërbim në komunitet; -Të zhvillohet një protokoll për projekte për të mirën e përgjithshme në UP dhe në komunitet.	-Të matet progresi në drejtim të qëllimit. - Draftimi i procedurave - Numri i shërbimeve të ofruara në komunitet	Prill, 2020	Menaxhmenti/ NJA/ QZHK	15,000
Ngritje e performancës akademike	Vlerësimi i performancës së studentëve bazuar në sistemin e Bolonjës	-Dizajnimi i procesit të vlerësimit të performancës së studentëve bazuar në sistemin e Bolonjës; - Të zhvillohet orari i mësimit dhe provimeve on-line	- Sistemi për përcjelljen implementuar për performancën e studentëve në vend; - SEMS-i të përfshijë orarin e mësimit dhe provimeve	Prill, 2020- Mars 2022	KD/Menaxhmenti/ Senati/NJA/	



2. Puna kërkimore shkencore/artistike						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – aktivitetet	Indikatorët	Afatet kohore	Stafi përgjegjës	Burimet/ kosto në euro
Të rriten rezultatet e kërkimit shkencor/artistik	Promovimi i kërkimeve shkencore/artistike për stafin akademik në revista të mirëfillta shkencore dhe platformë kredibile.	<ul style="list-style-type: none">- Raportimi në baza vjetore për rezultatet e arritura dhe masat obligative të ndërmarra- Krijimi i grupeve kërkimore shkencore/artistike në kuadër të NjA-ve.	<ul style="list-style-type: none">-Numri i punimeve të publikuara;-Numri i konferencave-Numri i grupeve kërkimore shkencore/artistike të themeluara	Prill, 2020- vazhdon	Menaxhmenti/NjA/ZKPS	1% e buxhetit vjetor të UP-së
	Mbështetja e përvetësimit të granteve kërkimore/shkencore nga agjencitë kombëtare të financimit dhe institucionet private apo publike.	<ul style="list-style-type: none">-Krijimi i dispozitave ligjore të nevojshme;-Përditësimi i vazhdueshëm i informatave në ballinën e ueb faqes së UP-së për mundësitë e financimit kërkimore/shkencore/artistik;-Trajnimi i stafit për aplikime në grante kërkimore	<ul style="list-style-type: none">- Ofrimi i dispozitave ligjore të nevojshme;-Ofrimi i informatave të përditësuara vazhdimisht në ballinën e ueb faqes së UP-së për mundësitë e financimit;-Rritja e aplikimit për grante kërkimore shkencore nga ana e stafit akademik	Prill, 2020- vazhdon	Menaxhmenti (ZMJ/ZZHA)NJ A/ ZKPS	Zero kosto



2. Puna kërkimore shkencore/artistike						
Objekti strategjik	Qëllimi	Detyrat – aktivitetet	Indikatorët	Afatet kohore	Stafi / përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
Përmirësimi dhe rritja e rezultateve hulumtuese në UP.	Inkurajimi i përfshirjes së kapaciteteve të diasporës në kërkime shkencore/ arte dhe aktivitete zhvilluese artistike si dhe përmirësimi i bashkëpunimeve tjera ndërkombëtare	-Vendosja e kontakteve dhe përkrahja e hulumtuesve nga diaspora. - Zhvillimi i kontakteve me hulumtues tjerë ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së bashkëpunimeve kërkimore/shkencore	- Identifikimi i kontakteve dhe hulumtuesve mbështetës nga diaspora; - Krijimi i bazës së të dhënave të kontakteve të hulumtuesve nga diaspora; - Promovimi i pozitës për profesorët “adjunct” për ligjërime dhe hulumtime nëpër njësitë akademike që kanë në dispozicion kapacitete.	Qershor, 2020	Menaxhmenti (ZZHA/ TI) NJA	45,000 Zero kosto
		-Përcaktimi i detyrimeve kontraktuale për veprimtari kërkimore shkencore/artistike për stafin akademik.	-Krijimi i bazës ligjore dhe rregulloreve për angazhimin e stafit të UP-së duke u bazuar në praktikatat më të mira evropiane.	Qershor, 2020	Menaxhmenti (ZZHA/ TI) NJA	Zero kosto
	Ngritja e integritetit akademik gjatë punës kërkimore/shkencore/artistike .	-Adresimi i rasteve të plagjiarizmit te stafi akademik dhe studentët.	- Aplikimi i programeve softuerike dhe implementimi.	Qershor 2020- dhe në vazhdim	Menaxhmenti/ Senati/ Këshilli i Etikës/ NJA	30,000



PLANI STRATEGJIK I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS 2020-2022

Inovacioni gjatë punës kërkimore/sh këncore/artistike .	Përkrahja e inovacioneve dhe mbrojtja e pronës intelektuale të UP-së.	-Hartimi i bazës ligjore për inovacionet; -Harmonizimi i Ligjit për Pronësinë Intelektuale në rregulloret e UP-së.	-Rregullorja për inovacionet në UP; -Futja e deklaratës etike për pronësinë intelektuale dhe inovacionin; -Hartimi i rregullores për pronësinë intelektuale të UP-së.	Dhjetor 2020	Menaxhmenti/ Senati/ Zyra për projekte të sponsorizuara/ NJA	Zero kosto
--	--	---	---	--------------	--	-------------------

3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi

Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies me qëllim të zhvillimit të kompetencave të studentëve.	Inkurajimi i vazhdueshëm i zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.	-Zhvillimi dhe implementimi i protokolleve për partneritet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.	-Numri i partneriteteve me institucionet vendëse dhe ndërkombëtare; -Numri i stafit të trajnuar gjatë procesit të përmirësimit të cilësisë.	Prill, 2020 - procesi vazhdon	UP/ NJA	Zero kosto
		-Kontakti me institucionet ndërkombëtare; -Zhvillimi i bazës ligjore për bashkëpunim; -Zhvillimi dhe akreditimi i programit për studime ndërdisiplinore; -Administrimi i anketës (post- implementim të gjeneratës së parë të të diplomuarve).	- Numri i programeve ndërdisiplinare në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe shkencës.	Prill, 2020 - procesi vazhdon	Menaxhmenti (ZZHC/ZMJ/ Komisioni për studime/Senati) NjA,dhe AKA	100,000



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
		<p>-Zhvillimi dhe akreditimi i programeve duke u bazuar në disiplinat prioritare për vendin që çojnë në dhënien e diplomave të përbashkëta;</p> <p>-Zhvillimi dhe administrimi i anketës pas përfundimit të gjeneratës së parë të të diplomuarve);</p> <p>- Analiza e rezultateve të anketës dhe raportimi</p>	<p>-Numri i programeve të bazuar në disiplinat prioritare të vendit që çojnë në dhënien e diplomave të përbashkëta.</p> <p>- Numri i anketave të realizuara;</p> <p>-Numri i ngjarjeve të realizuara</p>	Tetor, 2020-shtator, 2022-	Menaxhmenti (ZZHC/ZMJ/ Komisioni për studime/ Senati) NjA,dhe AKA	180,000
		<p>-Zhvillimi i një platforme për rishikim në përputhje me planin e punës të mbikëqyrur nga ZZHA-ja dhe Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë;</p> <p>-Zhvillimi i metodave të mësimdhënies, të cilat rrisin pjesëmarrjen aktive (studentëve);</p> <p>-Zhvillimi dhe akreditimi i programeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p>	<p>-Vendosja e procesit të rishikimit të vazhdueshëm të programit.</p> <p>-Metodat aktive të realizuara të mësimdhënies.</p>	Qershor, 2020 - vazhdon	Menaxhmenti (ZZHC/ZMJ/ Komisioni për studime/ Senati) NjA,dhe AKA	Zero kosto



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi

Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
			-Finalizimi i sistemit të mësimit gjatë gjithë jetës. - Numri i programeve të zhvilluara dhe akredituara për të mësuarit gjatë gjithë jetës.			
	Mbështetja e të mësuarit të bazuar në hulumtim dhe krijimi i një mjedisi të të mësuarit me studentin në qendër.		-Rezultatet e të mësuarit të zhvilluara për secilin program para se të dorëzohen për akreditim /riakreditim.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	ZZHC/ KQSC /QPM NJA	Zero kosto
		-Zhvillimi i metodave më të mira për mësimnxënie të bazuar në hulumtime për të gjitha nivelet e programeve të studimit para akreditimit dhe gjate implementimit.	-Numri i metodave të përdorura të bazuara në hulumtim	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	ZZHC/ KQSC /QPM NJA	Zero kosto



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
		-Shtimi i komponentëve të hulumtimit shkencor/artistik në programet e studimit (PBL, Case study, etj).	- Përqindja e programeve bazuar në hulumtim shkencor/artistik	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	ZZHC/ KQSC /QPM NJA	Zero kosto
		- Zhvillimi dhe përkrahja e mësimdhënies interaktive për studentë .	- Metodatat e përdorura interaktive të mësimdhënies.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	ZZHC/ KQSC/ QPM/ NJA	Zero kosto
		-Rritja e ndërgjegjësimit për praktikatat dhe shkathtësitë më të mira të të mësuarit (duke përfshirë të mësuarit e bazuar në hulumtim dhe të e-mësimit).	- Numri i ngjarjeve të organizuara me qëllim të mësuarit e bazuar në hulumtim dhe të e-mësimit - - Materialet e publikuara në ueb faqe të UP-së.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	ZZHC/ ZZHC/ KQSC/ QPM/ NJA	Zero kosto
		-Mbështetje studentëve që të marrin përgjegjësi dhe të përfshihen në asistim në mësimdhënie (studentët e PhD, studentët demonstratorë).	-Numri i studentëve dhe lëndëve të përfshira në mësimnxënie; -Anketat vjetore për të matur ndryshimin siç perceptohet nga studentët dhe fakulteti.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	ZZHC/ TI/ PS/ ZZHC/ KQSC/ QPM/ NJA	Zero kosto



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
		-Hartimi i bazës ligjore për pjesëmarrje të studentëve në vlerësim të lëndëve /programeve dhe në mekanizma të tjerë të sigurimit të cilësisë.	-Ndryshime ligjore (statutore) të nevojshme për të mundësuar këtë pjesëmarrje. - Pjesëmarrje e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë	Prill, 2020– proces i vazhdueshëm	Menaxhmenti /ZZHC	Zero kosto
		-Mbështetje e studentëve në organizimin dhe pjesëmarrjen në ngjarje shkencore/artistike e profesionale (konferenca, punëtori, etj.)	- Baza ligjore e zhvilluar për pjesëmarrje të studentëve në ngjarje shkencore/artistike -Numri i studentëve pjesëmarrës në konferenca dhe punëtori.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	KD-UP, menaxhmenti (ZZHC/ TI/ PS/ KQSC/ QPM)/ NJA	Zero Kosto 150,000
		-Mbështetje studentëve në përpjekje të tyre për punësim.	- Mekanizmat mbështetës të zhvilluar përkitazi me profesionet e tyre të studimit (zhvillimi i mekanizmave të raportimit të punësueshmërisë (baza qendrore e të dhënave, qeveria, sektori privat, ALUMNI, etj.); - Formulari i vlerësimit / raportimit për të	Prill, 2020– proces i vazhdueshëm	Menagjimenti (ZZHC/ TI/ PS/Asociacioni ALUMNI, KQSC) Senati NJA	6,000



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
			identifikuar përdorimin e kompetencave të fituara për zhvillimin e karrierës së tyre dhe zhvillimin e tyre si nxënës gjatë gjithë jetës.			
		<p>-Promovimi i UP-së, respektivisht programeve studimore për të interesuarit potencialë (shkollat e mesme);</p> <p>-Marrja parasysh e nevojave të studentëve duke filluar nga parapërgatitjet për regjistrim deri te diplomimi dhe punësimi i tyre.</p>	<p>- Përkufizimi i mekanizmeve promovues;</p> <p>-Identifikim i grupeve të studentëve dhe stafit për promovim;</p> <p>-Përgatitja e materialit promovues për program/NjA dhe UP;</p> <p>- Përkufizimi i mekanizmit të paraaplikimit dhe procesit të aplikimit të të rinjve (konkursi, ditët shpjeguese; materialet promovuese në ueb faqe, trajnimi i stafit ndihmës për realizim të aplikimit, etj.)</p> <p>- Java orientuese për të regjistruarit</p>	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	Menaxhmenti (ZZHC/ TI/ PS ZZHC/ KQSC) NJA	15,000



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
		Inkurajimi i talenteve më të mirë për të studiuar në UP.	- Numri i talenteve të inkurajuar për të studiuar në UP (fituesit, etj.);			
		-Ruajtja e një mjedisi të ndryshëm social dhe kulturor.	-Një numër të mekanizmave dhe programeve të reja, të cilat propagandojnë në një mjedis të ndryshëm social dhe kulturor.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	Menaxhmenti/ZZHC/NJA/	6,000
	Përmirësimi i mjediseve fizike dhe virtuale të të nxënit	-Përcaktimi i mjediseve aktuale fizike dhe virtuale në UP; -Zhvillimi dhe /ose përmirësimi i mjedisit fizik dhe pajisjeve virtuale në UP.	-Studimi bazë i përfunduar për mjedisin aktual; -Numri i objekteve/anekseve të reja të ndërtuara.	Prill, 2020 – proces i vazhdueshëm	UP / NJA	15,000



3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi / Përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
